



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 18.10.2024, me fillim në orën 10:10. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e **dhjetë (10)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2026;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2028;
4. Shqyrtimi i raportit financiar janar – shtator 2024;
5. Shqyrtimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, P-00772-10, ZK - Xërxë;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës, P-05537-2, ZK - Rahovec;
7. Të ndryshme.

**Shtesë:**

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Ratkoc;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë;

**Kryesuesi:** Atëherë, pas leximit rendi të ditës, në emailat e juaj i keni edhe 3 pika shtesë nga Drejtoria e Arsimit.

**Avni Morina:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, kolegë drejtorë. Këto tri propozime vijnë si rezultat i angazhimit tonë që e kemi pasur gjatë muajve të fundit. Kemi marrë pëlqimin nga Ministria e Arsimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe, në Ratkoc dhe në Xërxë dhe sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it nr.10/23, duhet të merret miratimi nga Kuvendi Komunal. Paraprakisht, komuna jonë i ka plotësuar të gjitha kriteret e këtij udhëzimi administrativ. Në konsultim me Zyrën e Kuvendit, kërkova që të futen me një pikë, mirëpo, për shkak të procedurës, kërkohet që vendimet të ndahen veç e veç.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Atëherë, i vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota “për”) miratohen tri pikat shtesë. Të nderuar anëtarë, tani e vendosim rendin e ditës si të tillë në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota “për”) aprovohet rendi i ditës. Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë, vazhdojmë me pikën e parë.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë diskutim rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë votash (5 vota “për”) miratohet pika e parë e rendit të ditës.

**2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2026:**

**Alban Gashi:** Përshëndetje, kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive! Ky plan është një përpjekje e përbashkët e grupit punues për hartimin e planit të veprimit, mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje në Rahovec, në koordinimin e Zyrës së Kryetarit dhe me përkrahjen e misionit të OSBE-së në Kosovë. Ky plan është i obliguar sipas ligjit nr. 08.L/185. Dokumenti ka qenë në konsultim publik nga data 15 gusht-16 shtator dhe konsultimi publik me qytetarë është mbajtur më 9 gusht. Pjesëmarrësit kanë dhënë ide, të cilat janë inkorporuar në brendi të planit. Plani është i mbështetur në tri objektiva strategjike: përmirësimi i sistemit institucional për parandalimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe objektiva e tretë është fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Alban Gashi! A kemi ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht votohet pika e dytë e rendit të ditës, me pesë vota pro.

**3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2028:**

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit, kryesues! Para vetes e keni materialin për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, 2024-2028. Ky plan i ka kaluar të gjitha procedurat sipas ligjit, për të gjitha pyetjet tuaja jam këtu dhe më hollësisht do të prezantoj në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (5 vota) votohet pika e tretë e rendit të ditës.

**4. Shqyrtimi i raportit financiar janar – shtator 2024:**

**Afrim Limani:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së! Përmbajtja e raportit financiar nëntëmujor, zakonisht përbëhet nga të hyrat vetanake, tatimi në pronë, realizimi i buxhetit dhe raportet për kontratat e nënshkruara publike. Të hyrat e rregullta janë 1.341.726 €. Realizimi i tatimit në pronë gjatë kësaj periudhe është rreth 782.000 € dhe te realizimi i buxhetit deri më tani janë shpenzuar rreth 17.4 milion €. Për të gjitha pyetjet tuaja jam këtu dhe për shpjegime më të hollësishme në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (5 vota) votohet pika e katërt e rendit të ditës.

**5. Shqyrtimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, P-00772-10, ZK – Xërxë:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! Bëhet fjalë për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, deri në 20 vjet përmes procedurës së shprehjes së interesit. Vendi i quajtur Gradish, ZK -Xërxë, me numër të parcelës 00722-10, me sipërfaqe 2350m<sup>2</sup>. Ju ftoj që ta votoni këtë pikë për në Kuvend.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (5 vota) votohet pika e pestë e rendit të ditës.

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës, P-05537-2, ZK – Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Po shpallim me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës 05537-2, ZK – Rahovec, me sipërfaqe 5.4m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 300m<sup>2</sup> në vendin e quajtur Przhina me pronar Timendar Shtavica. Qëllimi i këtij vendimi është këmbimi i pronës private me atë komunale.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht (5 vota) votohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Vazhdojmë te pikat shtesë, të trija paraprakisht i prezantoi drejtori.

**7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Krushë të Madhe:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush nuk ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (5 vota) votohet pika e parë shtesë dhe e shtata sipas renditjes në rend të ditës.

**8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Ratkoc:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (5 vota) votohet pika e dytë shtesë dhe e teta sipas renditjes në rend të ditës për këtë mbledhje.

**9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (5 vota) votohet pika e tretë shtesë dhe e nënta sipas renditjes në rend të ditës për këtë mbledhje. Kemi arritur te pika e fundit me numër dhjetë.

**10. Të ndryshme:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush ka ndonjë koment? Nëse jo, atëherë ju falënderoj për kontributin! Shihemi në fund të muajit, në mbledhjen e rregullt të Kuvendit!

**P.s.:** Gjatë mbledhjes, ka pasur probleme teknike me incizim, procesverbali nuk është regjistruar fare si audio. I tëri është shkruar me dorë.

**Procesmbajtësi:**

  
Albion Krasniqi

**KRYESUESI:**

  
Arbër Zenuni

